



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
ZYRA SHQIPTARE PËR TË DREJTAT E AUTORIT

Nr. Prot.

Tiranë, datë / / 2016

Lënda: Analiza vjetore mbi aktivitetin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit për periudhën Janar-Dhjetor 2015

Drejtuar :

Znj. MIRELA KUMBARO (FURXHI)

MINISTËR

MINISTRIA E KULTURËS

Për Dijeni:

Z. EDMOND AHMETI, KËSHILLTAR

MINISTRIA E KULTURËS

E nderuar Znj. Ministre,

Më lejoni t'Ju informoj mbi aktivitetin dhe punën e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, për periudhën Janar- Dhjetor 2015, në mënyrë të detajuar si më poshtë vijon:

❖ **“DRAFT LIGJI PËR TË DREJTËN E AUTORIT”**

Ligji “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura” (LDA) aktualisht në fuqi është pjesërisht i përputhur me *acquis communautaire*.

Projekt-ligji i ri “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura” pas rishikimit të tij nga grupi i punës i ngritur nga Ministria e Kulturës, dhe pas raundit të dytë të konsultimeve për të inkorporuar të gjitha sugjerimet e dhëna nga Ministrinë e Linjës dhe institucionet e tjera zbatuese por dhe grupet e interesit. Miratimi i këtij ligji mbetet prioritet i Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe Ministrinë së Kulturës.

Ashtu siç është theksuar dhe më parë ky projekt-ligji do të jetë në përputhje të plotë me acquis communautaire, në zbatim të nenit 73 të MSA-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ku ka aderuar Republika e Shqipërisë.

Projektligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të është miratuar në Këshillin e Ministrave në Shtator të vitit 2015 dhe pritet që të diskutohet në Komisionet Parlamentare. Miratimi i tij është parashikuar deri në janar të 2016.

❖ STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZBATIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE 2010-2015

Në kuadër të strategjisë, për fushën e pronësisë intelektuale, është projektuar një qasje më e gjerë ndër- institucionale për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë dokument. Ajo çka duhet të theksojmë është se vonesa e miratimit të Draft Ligjit për të Drejtën e Autorit ka sjellë mos-realizimin e detyrave të tjera të cilat janë të lidhura në mënyrë direkt me miratimin e Draft- ligjit.

Ndodhur në këto kushte ku ZSHDA është penguar në realizmin e detyrave të saj në përmbushje të misionit për të cilin është krijuar, sërish me mundësitë e saj ka arritur të përmbushë suksesshëm një pjesë të konsiderueshme të detyrave të veta që i burojnë nga Ligji në fuqi.

Në mbledhjet e grupit ndër-institucional të punës për monitorimin e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Zbatimit të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (2010-2015) është diskutuar mbi mos-realizimin e detyrave që lindin nga ky dokument. ***Miratimi i Draft Ligjit për të Drejtën e Autorit vazhdon të mbetet një prioritet i fushës së pronësisë intelektuale i cili duhet të miratohet pa vonesë, rekomandim ky dhe i ekspertëve të BE-së.***

Në kuadër të bashkëpunimit ndër –institucional dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zbatimin e të Drejtave të PI, ZSHDA ka patur këtë bashkëpunim si më poshtë:

Më datë 16/03/2015 u nënshkrua Memorandumi i Përbashkët me Autoritetin e Konkurrencës dhe Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit me qëllim:

- Nevojën për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni, në mënyrë që të lehtësohet kryerja e funksioneve të tyre përkatëse në mbështetje të legjislacionit në fuqi;
- Synimin për krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e lidhjeve dypalëshe;
- Mbështetjen në parimet e barazisë dhe përfitimit të përbashkët;
- Konsiderimin e rolit të rëndësishëm të politikës së konkurrencës në treg ;
- Parimin e transparencës në veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës dhe Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit

Më 3 qershor 2015 u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit midis ZSHDA dhe Universitetit Luarasi.

Më 15 Qershor 2015 u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit midis ZSHDA dhe Rektoratit të Universitetit të Tiranës.

Më datë 16 Korrik 2015 u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit midis ZSHDA dhe Universitetit Marin Barleti.

Më datë 29 qershor 2015 u zhvillua një takim zyrtar midis ZSHDA dhe përfaqësuesve të Ambasadës Bullgare, qëllimi i të cilës nuk ishte vetëm krijimi i urave të bashkëpunimit me këtë institucion por dhe vendosja e një bashkëpunimi të ngushtë me Zyrën Bullgare të Drejtës së Autorit.

Me date 19 Nëntor 2015 midis Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe Zyrës Rumune për të Drejtën e Autorit u nënshkrua memorandumi i Bashkëpunimit për të forcuar bashkëpunimin në të ardhmen në fushën respektive të të drejtës së autorit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 112 datë 26/08/2015, për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të punës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të dokumentit strategjik për Pronësinë Intelektuale 2016-2020, në datat **30 nëntor - 4 dhjetor 2015** asistoi qeverinë Shqiptare një grup ekspertësh nga WIPO, me objektivin e vetëm të ndihmojë grupin e punës në hartimin e strategjisë së re. Grupi i ekspertëve të WIPOs ka marrë takim me të gjitha institucionet shtetërore që janë pjesë përbërëse e këtij procesi si dhe me grupe të ndryshme interesi dhe me komunitetin e biznesit. Pikerisht me date 30 nëntor, dite e cila ishte caktuar për institucionet e të drejtës së autorit dhe grupet e intersit, këta ekspertë zhvilluan takimet përkatëse me përfaqësuesit e ZSHDA, AMA, Agjensitë e menaxhimit kolektiv si dhe grupe të ndryshme interesi. Takimi me ZSHDA-në u zhvillua në ambientet e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Strategjia e Re pritet të përmirësojmë ndjeshëm bashkëpunimin ndër-institucional në procesin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për pronësinë intelektuale në tërësi.

I. SEKTORI I REGJISTRIM-ÇERTIFIKIMIT DHE ANKIMEVE RELATON KËTË PËRMBUSHJE TË DETYRAVE NË HARKUN KOHOR TË LARTPËRMENDUR:

Në Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015, janë regjistruar-certifikuar sipas klasifikimit administrativ, si më poshtë; Regjistrim-certifikim të drejtë autori ; Janë regjistruar dhe certifikuar **60 (gjashtëdhjetë) certifikata të drejtë Autori**. Regjistrim-certifikim kalim të drejtash pasurore; Janë regjistruar-certifikuar 11 (njëmbëdhjetë) certifikata kalim të drejtash pasurore. Regjistrim kontratash; Janë regjistruar **7 (shtatë) kontrata** të subjekteve të ndryshme.

Gjatë kësaj periudhe janë refuzuar për regjistrim-certifikim një numër i madh kontratash për kalim të drejtash pasurore, gjatë shqyrtimit të këtyre kontratave rezultoi se nuk ishim bërë sipas parashikimeve të ligjit nr 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera, të lidhura me të”, i ndryshuar, dhe legjislacionit civil në fuqi, për të cilat janë dhënë shpjegimet me shkresë nga ana e ZSHDA mbi arsyet e refuzimit të këtyre kontratave.

Përsa i përket regjistrim-certifikimit të objekt veprimtarisë të subjekteve që shfrytëzojnë vepra letrare, artistike ose shkencore, në bazë të ndryshimit të nenin 130, të ligjit nr 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera, të lidhura me të”, regjistrimi dhe certifikimi i objekt veprimtarisë nuk është më i detyrueshëm për subjektet e ndryshme. Janë në proces regjistrimi-certifikimi një numër i konsiderueshëm aplikimesh, ku pasi të shqyrtohet dokumentacioni i nevojshëm do të procedohet me regjistrim-certifikimin e veprave të ndryshme sipas klasifikimit administrative.

Duke marrë parasysh shqetësimet e shumë autorëve të veprave të ndryshme letrare, artistike, shkencore, sektori i regjistrim-certifikimit ka dhënë të gjithë ndihmesën e duhur për të orientuar drejtë autorët mbi të drejtat dhe detyrimet që ato kanë mbi veprat e tyre në bazë të ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”. Gjithashtu subjekteve juridike që kanë si objekt veprimtarie prodhuese, tregtare apo çdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, artistike ose shkencore, u është dhënë ndihma e nevojshme nga ana e ZSHDA për problemet që ato hasin gjatë aktivitetit të tyre tregtar, në raport me të drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera, të lidhura me të.

1. Procedimet administrative

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar **147 procedime administrative**, nga të cilat:

- 2 procedim administrativ ka përfunduar në favor të palës ankimuese.

Pasi është zhvilluar procesi administrativ dhe janë shqyrtuar të gjitha provat në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjit “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta e Tjera të Lidhura me të”, SRCA-ja ka shprehur qëndrimin e saj me aktin “Shpjegim Përfundimtar” në favor të palës ankimuese.

- 4 procedime administrative janë braktisur nga pala kërkuese.
- 31 procedime administrative janë pezulluar me kërkesë të palës kërkuese.
- 42 procedime administrative janë duke u shqyrtuar nga SRCA-ja. në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjit “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta e Tjera të Lidhura me të”
- 24 procedime administrative kanë përfunduar duke u zgjidhur me mirëkuptim midis palëve ose pala kërkuese ka hequr dorë nga pretendimet e ngritura në ankimin administrativ.

- 44 procedime administrative janë pushuar pasi janë gjetur mangësi në kërkesën fillestare të palës kërkuese dhe nuk janë korrigjuar, ose pala nuk ka arritur të provojë pretendimet e tij.

1. Ndërmjetësimi:

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar **14 (katërbëdhjetë) ndërmjetësime**, ku në të gjitha rastet ankimuesit kanë qenë subjekte përdorues të pronësisë intelektuale, dhe kanë kërkuar ndihmën e ZSHDA-së për të negociuar tarifat e Agjencisë së Administrimit Kolektiv.

ZSHDA në bazë të nenit 104 të ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 (i ndryshuar), ka zhvilluar seanca ndërmjetësimi me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes me mirëkuptim, nga të cilat:

- 1 seanca ndërmjetësimi, palët kanë arritur zgjidhjen e mosmarrëveshjes me mirëkuptim.

Pasi është zhvilluar seanca e ndërmjetësimi dhe palët kanë negociuar me Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjit “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta e Tjera të Lidhura me të”, kanë arritur zgjidhjen e mosmarrëveshjes me mirëkuptim.

- 13 seanca ndërmjetësimi, palët nuk kanë arritur zgjidhjen e mosmarrëveshjes me mirëkuptim.

Pasi është zhvilluar seanca e ndërmjetësimi dhe palët kanë negociuar me Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjit “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta e Tjera të Lidhura me të”, nuk kanë arritur zgjidhjen e mosmarrëveshjes me mirëkuptim.

2. Ankesa mbi masat administrative:

- 80 (tetëdhjetë) subjekte përdoruese të pronësisë intelektuale kanë ankimuar masat administrative të vendosura nga inspektorët e ZSHDA-së.

Nga shqyrtimi i ankesave rezultoi se ankimuesit ishin njoftuar për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të ligjit “për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”, por nuk i kishin përmbushur këto detyrime.

3. Proceset Gjyqësore

SRCA – ja gjatë kësaj periudhe ka përfaqësuar ZSHDA-në në

34 procese gjyqësore, si më poshtë:

- **Në 6 procese gjyqësore ZSHDA-ja ka qenë palë e tretë, nga të cilat:**

- 4 raste kanë përfunduar në favor të paditësit;
- 1 rast ka përfunduar në favor të palës së paditur;
- 1 rast është pezulluar me kërkesë të palës.

(Në këto çështje, objekt padie është “cenimi i së drejtës së autorit”)

- **Në 25 proces gjyqësor ZSHDA-ja ka qenë palë e paditur nga të cilat:**

- 16 raste kanë përfunduar në favor të ZSHDA-së;
- 3 raste kanë përfunduar në favor të paditësit;
- 1 rast është pushuar me kërkesë të palës paditëse;
- 5 raste ende vazhdon procesi gjyqësor.

- **Në 2 proces gjyqësor ZSHDA-ja ka qenë palë paditëse, të cilat janë pushuar.**

- **Në 2 proces gjyqësor të cilat janë zhvilluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale, ku procesi vazhdon.**

4. Urdhër Ekzekutimi

Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit ka kërkuar lëshimin Urdhrit të Ekzekutimit në 23 raste, dhe ka kërkuar ekzekutimin e titullit ekzekutimit.

II. SEKTORI I INSPEKTIMIT / MONITORIMIT DHE ZRDA-VE

Në lidhje me shërbimet e ndërgjegjësimit në ZSHDA, ky institucion është përpjekur në mënyrë maksimale për të bërë ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut dhe të komunitetit në tërësi në lidhje me konceptet e të drejtës së autorit dhe të drejtat e lidhura, dhe jo vetëm në kuadër të strategjisë, por kjo është dhe një nga detyrat kryesore të ZSHDA-së. Është raportuar në mënyrë kronologjike për fushatat dhe tryezat e përbashkëta që janë zhvilluar sa i takon fushës.

Një pjesë shumë të rëndësishme të cilën ZSHDA e klasifikon dhe si proces ndërgjegjësim dhe informimi është monitorimi dhe inspektimi i Tregut të Pronësisë artistike, pjesë e cila kryhet nga inspektorët e ZSHDA. Më poshtë po Ju japim statistikën në lidhje me rregjistrimet dhe inspektimet si dhe procedimet administrative që zhvillohen pranë ZSHDA-së:

- Në qarkun Tiranë janë monitoruar subjektet si më poshtë:

Librari	49
Fotokopje Kancelari	80
Shtëpi diskografike	2
Call Center - Servis Komjuterash- Tregëti Karburanti	140
Videoteka	2
Radio	19
Baste Sportive	5
Bar, Kafe ,Restorant	287
Hotel	40

- Në qarkun Durrës janë monitoruar:

Librari	13
Fotokopje	6
Call Center	9
Bar Kafe Restorant Hotel	146

- Në qarkun Shkodër Lezhë janë monitoruar këto subjekte:

Bar Kafe Hotel	124
Fotokopje	8
Call Center	17
Librari	8
Videoteka	2
Televizion	1

- ZONA Lushnjë – Vlorë

Librari	12
Fotokopje	4
Call Center	1
Televizion kabllo	1
Bar Kafe Restorant	8

- ZONA Elbasan, Pogradec, Korçë

Librari	15
Bar Kafe	1

Fotokopje	15
Call Center	3

- **ZONA Fier , Berat, Balsh**

Librari	15
Fotokopje	24

- **ZONA Kukës, Peshkopi, Burrel**

Fotokopje	14
Librari	3

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015 janë marrë **218 masa administrative** sipas kategorive të subjekteve si më poshtë:

Televizion Valor+Kabllor	84
Fotokopje	11
Call Center	7
Videoteka	1
Radio	18
Bar, Kafe, Restorant, Hotel	93
Gazeta	3
Subjekti Sig Ship	1

Gjatë monitorim/inspektimit Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit ka konstatuar një sërë problematikash dhe është munduar të japë edhe sugjerimet e veta për zgjidhje;

- a) Në kuadër të inspektimeve lidhur me kategorinë e përdoruesve të veprave shkencore (programet kompjuterike) institucioni është ndeshur me një seri problemesh lidhur me trajtimin e pjesës së licencimit të sistemeve operative,, pasi pjesa me e madhe e kompjuterëve që hyjnë ne territorin e Republikës së Shqipërisë janë kompjuterë të përdorur me një pullë ekzistuese (OEM) dhe gjate inspektimeve Inspektorët janë ndeshur me problematikën specifike se si duhej trajtuar, si një sistem i licencuar apo si një sistem i palicencuar.

Në saje të punës që institucioni bëri për një zgjidhje sa me te shpejte të këtij ngërçi ne bashkëpunim edhe me Microsoft u arit që për here te parë ne vendin tone të licencohej një operator për tregtimin e licencave refurbishet kjo pasi këto kopmjutera hyjnë pa asnjë lloj sistemi dhe kanë nevojë për një licencim.

- b) Për sa i përket pjesës së librit edhe këtu është hasur një problematike në kuadër të inspektimeve që janë kryer si ne librari ne pika fotokopjimi dhe Shtëpi botuese ku më kryesorja është pjesa e respektimi te elementeve te botimit të një vepre si (çmim, tirazh, shtëpi botuese etj) element të cilët duhet të vendosen nga ana e botuesit ashtu si dhe

pjesa e respektimit te kontratës (Nenin 40 të LDA-së) së botimit midis shtëpisë botuese dhe autorit.

Ne lidhje me këtë pjese Institucioni ka propozuar organizimin e një tryeze me libraret e te gjithë Shqipërisë ku te behej edhe një organizimi i tyre ne një shoqate në mënyre që edhe problematika e tyre të adresohet më qarte tek shtëpitë botuese.

❖ SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE ME PUBLIKUN

Përgjatë vitit 2015, Zyra është përpjekur maksimalisht të përfshijë studentët në procesin e rritjes së ndërgjegjësimit në fushën respektive. Konkretisht janë *organizuar takime të gjerë me Universitetet shtetërore publike dhe private dhe institucione të tjera arsimore*, për t'u bërë me dije detyrimet që u takojnë në bazë të legjislacionit në fuqi për të Drejtën e Autorit. Konkretisht më datë 16 Janar 2015 u zhvillua takimi me studentët e Universitetit Evropian te Tiranës, për të vijuar më tej me Universitetet e tjera Publike dhe Private në RSH dhe më datë 6 shkurt 2015 u zhvillua takimi me stafin akademik dhe me studentet e Universitetit EPOKA, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e gjeneratave që rriten. Më datë 22 Maj 2015 ky takim, ne formën e leksionit të hapur u zhvillua me Universitetin Luarasi.

Më datë **14 prill 2015** Drejtoria e përgjithshme e Policisë zhvilloi një sesion informativ me punonjësit e saj, në lidhje me çështjet e pronësisë intelektuale konkretisht të të drejtës së autorit dhe pronësisë industriale, të cilët u prezantuan nga punonjësit e zyrave respektive të pronësisë intelektuale. Këto sesione janë për tu vlerësuar pasi rritet niveli i informimit të strukturat shtetërore që janë pjesë e zbatimit të legjislacionit ne RSH.

Më datë **22 prill 2015** u zhvillua një Konferencë Kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme të Patentave dhe Markave dhe Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit me temë” *Pirateria dëmton kulturën, integritetin dhe ekonominë e një vendi*” – *Të respektojmë të Drejtat e Autorit në RSH*”. Ky aktivitet vjen në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale - 26 prill, ditë e cila festohet dhe celebrkohet nga të gjitha shtetet anëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale. Në këtë konferencë u ftuan të gjitha institucionet shtetërore të cilat janë pjesë kyçe e zbatimit të të drejtave të autorit, komuniteti i biznesit dhe ai i artistëve/krijues, grupe te caktuara të interesit etj.

Në kuadër të shërbimeve që ofron Komisioni Evropian me anë të Programit të Asistencës Teknike TAIEX/KE, Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA) ishte përfituese por dhe njëkohësisht dhe bashkë-organizatore e një workshopi ndër-Rajonal mbi “Sistemin e menaxhimit kolektiv” i cili u mbajt nga data **15-17 Prill 2015** në Tiranë me pjesëmarrjen e vendeve te Ballkanit Perëndimor (Kosovë, Mal i Zi, Serbi, Bosnje Hercegovine, Maqedoni) për të ndarë eksperiencat përkatëse në këtë fushë dhe përmirësimin e sistemit në fjalë sa i takon vendeve të përfshira.

Qëllimi i këtij eventit 3-ditor ishte forcimi i gjithë sistemit të menaxhimit kolektiv i së Drejtës së Autorit dhe i të drejtave të tjera të lidhura me të në vendet e përfshira, duke përfituar më të mirën

nga praktikat më të mira ndërkombëtare në mënyrë që të rritet roli dhe transparenca e CMOs në vendet e Ballkanit perëndimor.

Lektori i ftuar për të prezantuar në këtë event ishte një nga personalitetet më të shquar në fushën e të drejtës së autorit dhe specifikisht atë të menaxhimit kolektiv Z. Mihaly Fiscor me një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e zbatimit të drejtave të pronësisë intelektuale si dhe hartues i kuadrit ligjor në vendet e rajonit.

Në këtë aktivitet morën pjesë institucionet shtetërore zbatuese të të drejtave të pronësisë intelektuale të vendeve të këtij rajoni, si: Zyrat shtetërore të Markave dhe Patentave si dhe ato të Drejtës së Autorit, Inspektoratet e Tregut, Autoritetet Doganore dhe Tatimore, Policia e Shtetit, autorë, krijues, Agjenci të menaxhimit kolektiv të vendeve të cituara.

Në datat 27-28 Maj 2015 u zhvillua në Rumani (Cluj Napoca) një Konferencë Rajonale për sistemin e menaxhimit kolektiv e cila u organizua nga Zyra Rumune e të Drejtës së Autorit në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale. Këtu morën pjesë vendet e rajonit për të diskutuar sfida në lidhje me menaxhimin kolektiv të të drejtave dhe problematikat e fushës, transparenca, mireqeversja dhe supervizimi. Një përfaqësues i ZSHDA mori pjesë në këtë konferencë i cili prezantoi situatën aktuale më problematikat dhe arritjet në fushën përkatëse.

Ne 21-30 Tetor 2015 u trajnua në Finlande një specialiste e ZSHDA në kursin mbi të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura, e zhvilluar nga WIPO Academy, në bashkëpunim me Zyrën e të drejtës së Autorit në Finlandë dhe Ministrinë e Kulturës.

Me datë 18 dhe 19 Nëntor 2015 u organizua një Seminar Kombëtar – *Tryezë e rrumbullakët mbi mësimdhënien e PI*, organizuar nga WIPO, në bashkëpunim me Zyrën Rumune të Drejtës së Autorit (ORDA).

Qëllimi i këtij aktiviteti është diskutimi i zhvillimit dhe i përdorimit të përdorimit të Kurikulës së të drejtave të Pronësisë Intelektuale e adresuar kryesisht për arsimin e nivelit të mesëm.

Në këtë aktivitet morën pjesë 2 punonjës të ZSHDA të cilët përfituan nga praktika e Rumanisë, duke qenë se dhe RSH është në proces hartimi të kurikulave për shkollat e mesme, konkretisht klasat e 10-ta, si një Modul me zgjedhje për Pronësinë Intelektuale.

Aktivitete të tjera janë parashikuar për tu zhvilluar përgjatë vitit 2016.

Duke besuar në vullnetin dhe mbështetjen Tuaj maksimale,

EVIEN DAKO

DREJTOR